



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 910/5 Prot

Tiranë, më 31.12.2025

V E N D I M

Nr.79, datë 31/ 12 /2025

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës.”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkisë Malësi e Madhe,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 104 (910 prot.), datë 7.11.2025 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Malësi e Madhe”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 910/1 prot., datë 6.11.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe me shkresën nr. 910/2

prot., datë 7.11.2025 *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Malësi e Madhe”*.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Malësi e Madhe, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 910/3 prot., datë 12.12.2025, të Komisionerit, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, e ka dërguar materialin pranë Komisionerit të nënshkruar, pa observacione (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 910/4 prot., datë 24.12.2024).

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë eficiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të pozicioneve të shërbimit civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshtimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete në lidhje me këtë proces.

Për këtë arsye Komisioneri e vlerëson të rëndësishëm finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se nga ana e institucionit, nuk është kryer asnjë procedurë konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- në 66 raste janë emëruar punonjës në pozicione pune të shërbimit civil, në kundërshtim me kërkesat dhe procedurat e ligjit, në pjesën që rregullon institutin e rekrutimit; më tej, në 5 raste, titullari i institucionit të mbikëqyrur ka nxjerrë aktet e emërimit në një detyrë tjetër të shërbimit civil, pa u zbatuar procedurat e ngritjes në detyrë të përcaktuara nga neni 26, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe vendimi nr. 242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbytjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Malësi e Madhe, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbytje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.

3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës i përfunduar, të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.

Kryetari i Bashkisë dhe Njësia Përgjegjëse e institucionit të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e këtij vendimi paralajmërues, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna në raportin përfundimtar dhe në këtë vendim; b) subjekti/nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit; si dhe c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrative.

Plani i veprimit do të dërgohet pranë Komisionerit 2 muaj, pas marrjes dijeni për këtë vendim paralajmërimi.

5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

1. Denada Fikaj, emëruar në pozicionin “*Specialste IT*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nëpërmjet aktit nr. 04, datë 10.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë;
2. Marte Vanaj, emëruar në pozicionin “*Specialiste Protokolli*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet aktit nr. 184, datë 30.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
3. Sidnei Rexhvelaj, emëruar në pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë*” nëpërmjet aktit nr. 212, datë 16.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
4. Erdita Kekaj, emëruar në pozicionin “*Specialist e Marrëdhënieve me Jashtë*”, nëpërmjet aktit nr. 52, datë 26.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë;
5. Stiven Trungshi, emëruar në pozicionin “*Specialist Integrimi*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet aktit nr. 169, datë 04.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
6. Luan Nikaj, emëruar në pozicionin “*Specialist i Zyrës me një Ndalesë*”, nëpërmjet aktit nr. 161/2, datë 20.1.2025, të Kryetarit të Bashkisë;
7. Rozina Murrizi, emëruar në pozicionin “*Specialiste Kontabiliteti*”, nëpërmjet aktit nr. 176, datë 07.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë;
8. Gelantina Mukaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Asetesh*”, nëpërmjet aktit nr.149, datë 17.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
9. Elona Hepaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Juriste*”, nëpërmjet aktit nr. 105, datë 14.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
10. Emine Smakaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Juriste*”, nëpërmjet aktit nr. 95, datë 07.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë;
11. Desantila Rrustemaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Juriste*” në Sektorin Juridik, nëpërmjet aktit nr. 39, datë 23.3.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
12. Denis Gjellaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin Juridik, nëpërmjet aktit nr. 109, datë 8.8.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
13. Erald Kurtulaj, emëruar në pozicionin “*Inspektor Urbanistike*”, nëpërmjet aktit nr. 150, datë 24.09.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
14. Marsida Marinaj, emëruar në pozicionin “*Inspektore Urbanistike*”, në Sektorin e Urbanistikes, nëpërmjet aktit nr. 52, datë 25.03.2025, të Kryetarit të Bashkisë;
15. Xhensila Cubaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Projektsh*”, nëpërmjet aktit nr. 73, datë 19.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
16. Mariza Durgaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Projektsh*”, nëpërmjet aktit nr.141, datë 07.09.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
17. Elsad Curri, emëruar në pozicionin “*Specialist pranë Kadastrës*”, nëpërmjet aktit nr.147, datë 17.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
18. Esmeralda Bajramaj, emëruar në pozicionin “*Specialist i mbrojtjes se tokes*”, nëpërmjet aktit nr. 116, datë 03.08.2022. të Kryetarit të Bashkisë;
19. Ferit Hasaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Bujqesie*”, nëpërmjet aktit nr. 51, datë 29.03.2023, në Njësinë Administrative Qendër, të Kryetarit të Bashkisë;

20. Luan Kazmaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Kadaastre*”, nëpërmjet aktit nr.124, datë 7.8.2025, në Njësinë Administrative Kelmend, të Kryetarit të Bashkisë;
21. Elda Kukaj, emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit*”, nëpërmjet aktit nr. 133, datë 04.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë;
22. Juel Zaraj, emëruar në pozicionin “*Specialist Ambjenti*”, nëpërmjet aktit nr. 56, datë 10.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
23. Augert Malecaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Taksash*”, nëpërmjet aktit nr.178, datë 30.08.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
24. Klebeta Hysaj, emëruar në pozicionin “*Inspektor Taksash*”, nëpërmjet aktit nr.57, datë 19.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
25. Dorjeta Hoxhaj, emëruar në pozicionin “*Inspektor taksash*”, nëpërmjet aktit nr.94, datë 11.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
26. Jurgena Hoxhaj emëruar në pozicionin “*Specialist auditi*”, nëpërmjet aktit nr. 207, datë 03.10.2023, në Njësinë Administrative Qendër, të Kryetarit të Bashkisë;
27. Paola Brrakaj emëruar në pozicionin “*Specialist arsimi*”, nëpërmjet aktit nr. 146, datë 29.9.2025, në Njësinë Administrative Qendër, të Kryetarit të Bashkisë;
28. Nertila Bajramaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Biblioteke*”, nëpërmjet aktit nr. 20, datë 06.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë;
29. Sonila Metaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Rinie*”, nëpërmjet aktit nr. 24, datë 09.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
30. Xheride Shabaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Rinie*”, nëpërmjet aktit nr. 59, datë 12.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
31. Aleksander Rakaj emëruar në pozicionin “*Specialist Turizmi*” në Sektorin e Turizmit, nëpërmjet aktit nr. 85, datë 04.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
32. Melda Fili, emëruar në pozicionin “*Specialist Turizmi*” në Sektorin e Turizmit, nëpërmjet aktit nr. 18, datë 07.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
33. Fatjona Banushaj (Hysa) emëruar në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, nëpërmjet aktit nr. 89, datë 07.08.2018, në Njësinë Administrative Qendër, të Kryetarit të Bashkisë;
34. Liridona Balaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Strehimi*”, nëpërmjet aktit nr.151, datë 21.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
35. Dorisela Kalaj, emëruar në pozicionin “*Punonjëse Sociale*”, nëpërmjet aktit nr.169, datë 16.08.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
36. Bleona Laçi, emëruar në pozicionin “*Punonjëse Sociale*”, nëpërmjet aktit nr. 199, datë 26.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
37. Franc Vukaj, emëruar në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, nëpërmjet aktit nr. 189, datë 11.09.2023, në Njësinë Administrative Shkrel, të Kryetarit të Bashkisë;
38. Edisona Reçaj, emëruar në pozicionin “*Specialist e Ndhimes ekonomike*”, nëpërmjet aktit nr. 74, datë 08.06.2018, në Njësinë Administrative Gruemirë, të Kryetarit të Bashkisë;
39. Laureta Botinaj, emëruar në pozicionin “*Specialist e Ndhimes Ekonomike*”, nëpërmjet aktit nr. 03, datë 10.01.2025, në Njësinë Administrative Gruemirë, të Kryetarit të Bashkisë;
40. Fehmi Bajraktari emëruar në pozicionin “*Specialist Inxhinier Mekanik*”, në Sektorin e Shërbimeve Publike nëpërmjet aktit nr. 130, datë 09.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë;

41. Erisa Rrukaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance/Arkive/Prot*”, nëpërmjet aktit nr. 05, datë 12.01.2023, në Njësinë Administrative Qendër, të Kryetarit të Bashkisë;
42. Emirjan Kurtaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Turizmi*”, nëpërmjet aktit nr.198, datë 29.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
43. Mateol Broqaj, emëruar në pozicionin “*Inspektor Taksash*”, nëpërmjet aktit nr.137, datë 27.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
44. Gjovalin Decaj emëruar në pozicionin “*Specialist për Mbrojtjen e Mjedisit*”, nëpërmjet aktit nr. 113, datë 11.07.2019, në Njësinë Administrative Kastrat, të Kryetarit të Bashkisë;
45. Ervin Smakaj, emëruar në pozicionin “*Inspektor taksash*”, nëpërmjet aktit nr.108, datë 23.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
46. Dajana Rroku, emëruar në pozicionin “*Specialist finance/prot/arkive*”, nëpërmjet aktit nr. 181, datë 06.09.2023, në Njësinë Administrative Shkrel, të Kryetarit të Bashkisë;
47. Samina Lici, emëruar në pozicionin “*Specialist finance*”, nëpërmjet aktit nr. 123, datë 14.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
48. Pjetër Selboja emëruar në pozicionin “*Specialist shërbimesh Publike*”, nëpërmjet aktit nr. 94, datë 8.8.2017, në Njësinë Administrative Gruemirë, të Kryetarit të Bashkisë;
49. Skender Canaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Sherbimesh Publike*”, në Njësinë Administrative Gruemirë, nëpërmjet aktit nr. 21, datë 30.1.2025, të Kryetarit të Bashkisë;
50. Sara Durgaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet aktit nr. 03, datë 05.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
51. Manuel Maçaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i zyrës me një ndalesë*”, nëpërmjet aktit nr. 108, datë 13.9.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
52. Ermal Ademaj, emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Menaxhimit të Aseteve*”, nëpërmjet aktit nr. 16, datë 20.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
53. Ermelinda Volaj, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Projekteve të Kryetarit, nëpërmjet aktit nr. 19, datë 20.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
54. Xhenisa Dushaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse*” në Sektorin e Zhvillimit Urban, nëpërmjet aktit nr.191, datë. 13.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
55. Alda Popaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Kadastrës, nëpërmjet aktit nr.179, datë 16.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
56. Edona Laçaj, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e të ardhurave, nëpërmjet aktit nr. 18, datë 20.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
57. Gjovalin Popaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Kulturës dhe Sportit*”, nëpërmjet aktit nr. 14, datë 05.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
58. Esmeralda Kurtaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Rinisë*”, nëpërmjet aktit nr. 21, datë 09.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
59. Ndoc Prela, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Menaxhimit të Mbetjeve, nëpërmjet aktit nr. 92, datë 27.06.2024 të Kryetarit të Bashkisë;
60. Ilir Pelaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Shërbimeve Publike” nëpërmjet aktit nr. 161, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
61. Rosel Vocaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës*” në Sektorin e menaxhimit të Mbetjeve, nëpërmjet aktit nr. 42, datë 16.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë;

62. Emanuela Smakaj, me akt emërimi nr. 248/6 prot., datë 3.3.2021, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “*Specialist Protokoll në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore*”. Me urdhrin nr. 178 (3255 prot), datë 13.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
63. Pavlina Goraj, me akt emërimi nr. 4151/2 prot., datë 27.8.2019, të Njesisë përgjegjëse, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore*”. Me urdhrin nr. 20 (223 prot.), datë 20.1.2021, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme*”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
64. Dorina Shabi, me akt emërimi nr. 1385, datë 23.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “*Specialist QKB*”. Me urdhrin nr. 2 (16 prot), datë 5.1.2023, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Taksave*”, në Drejtorinë e të Ardhurave, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
65. Rovena Taflaj, me akt emërimi nr. 112/6, datë 13.1.2020, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “*Inspektor Taksash*”. Me urdhrin nr. 61 (1025 prot), datë 19.3.2021, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Transportit*”, në Drejtorinë e të Ardhurave, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
66. Donika Velaj, me akt emërimi nr. 646/2, datë 2.4.2021, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Me urdhrin nr. 17 (290 prot), datë 26.1.2023, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë*”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.
- Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.
7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, Prefekti i Qarkut Shkodër, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.
- Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Malësi e Madhe, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është

ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

Punoi: Z. Mujali

Pranoi: A. Shumeli

Miratoi: A. Basha